



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës
Nr. 02/ 120
Datë: 23.08.2021

PROCESVERBAL

i mbledhjes së parë (I) të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Malishevës

R E N D I D I T Ë S

1. Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve për Kompaninë “Ekoregjioni Jugor” njësia në Malishevë.

Mbledhja u mbajt me datë: 06.05.2021 dhe filloi në ora: 10:35. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 16 asambleistë, drejtorë komunalë dhe zyra për informim.

Rrahim Morina: Përshëndetje për të gjithë! Prezent në sallë janë 16 asambleistë. E hapi mbledhjen e parë të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Malishevës për vitin 2021, me të vetmen pikë të rendit të ditës Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve për Kompaninë “Ekoregjioni Jugor” njësia në Malishevë. Siç jeni të informuar, mbledhja është thirrur me iniciativën e juaj. Mbledhjen e kaluar kjo pikë është shtyrë për mungesë të materialit, dhe sot e kemi sjellë materialin, vetëm nënin ku ka të bëjë me formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve. Unë po e lexoj në tërsi nënën 5, pika 5.2 Kur një komunë është aksionare në një ndërmarrje publike lokale ka të drejtat e saj të aksionarit, do të thotë që ushtrohen nga një komision komunal i aksionarëve, i cili përbëhet nga një antarë i emëruar nga kryetari i komunës dhe nga dy antarë të emëruar nga kuvendi komunal. Për këtë qëllim Komisioni Komunal i

Aksionarëve ka të drejtë të veprojnë në emër të komunës përkatëse, në përputhje me ligjin për shoqatat tregtare, dhe Komisioni Komunal i Aksionarëve duhet me shumicë votash të vendosë se si do t'i ushtrojnë të drejtat aksionarët e komunës, për një çështje të caktuar. Pra, ligji na jep të drejtën ta formojmë Komisionin e Aksionarëve. Urdhëro, Sylë!

Sylë Dukolli: Përshëndetje asambleistë të pranishëm në sallë! Sa për sqarim a do të propozojmë antarë, apo çka do të bëjmë?

Rrahim Morina: Së pari formohet komisioni, nxjerret vendim i veçantë për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Kompaninë "Ekoregjioni Jugor" njësisia në Malishevë, pastaj propozohen antarët dhe votohen. Brenda kësaj pike nxjerren dy vendime. Vendimi i parë shënohet formimi i komisionit ndërsa vendimi i dytë plotësohet me antarë të kuvendit.

Sylë Dukolli: Ne jemi që të formohet komisioni.

Rrahim Morina: Urdhëro, Alban Mazreku!

Alban Mazreku: Përshëndetje, Kryesues! Ne si grup i PDK-së jemi që të krijohet ky komision.

Rrahim Morina: Urdhëro, Alban!

Alban Krasniqi: Faleminderit, Kryesues! Mendoj që themelimi i këtij komisioni është dashur të bëhet shumë kohë më parë. Jemi të vetëdijshëm që deri sa nuk është formuar ky komision, këtu janë marrur vendime nga komuna, ekzekutivi që ka disa kontrata përmes të cilave po qëndrojnë punsime të eprorëve, njerëzve partiak, në emër të shërbimeve kinse të realizuara për mirëmbajtje të hapsirave që i ka pasur në shfrytëzim komuna si prona të veta. Për këtë e kemi dërguar rastin dhe në polici. Kushdo që do të jetë në qeverisjen e re, unë besoj që do ta dërgoj përpara këtë proces të vendimit të plotë të gjitha kontratave që ka bërë komuna në këtë drejtim. Sepse nuk mundesh me mbulu një shërbim në emër të pasurimit dhe punsimit të njerëzve të parties. Nga stadium i futbollit, te salla e sportit, te shtëpia e kulturës, e ku do që këta i kanë cilësuar si shërbime për pastrim, kanë punsuar njerëz dhe të shkohet të shënohet gjendjen e këtyre objekteve është skandaloze. Tani jemi para një procesi të rëndësishëm dhe besoj që sot do të mbyllet si proces. Grupi jonë do të pajtohet që të votojmë vetëm ata që i kanë dy gjëra. E para nuk janë shërbëtorë të atyre që e kanë sjellë gjendjen e Ekoregjionit këtu, por që janë ata që e zgjedhin me konkurs të hapur sa më parë një antëarë të ri të bordit, i cili duhet të jetë përfaqësues në bazë të drejtës që është e rregulluar me rregulloren e qeveris, që të përfaqësojë komunën e Malishevës në Ekoregjion. E dyta ata të kenë për bazë që të fillojnë menjëherë një proces të mbledhjes së informacioneve dhe ta ndjekin rastin deri te organet e drejtësisë, për shkeljet që kanë ndodhur në këtë rast nga komuna, të cilat e kanë dëmtuar interesin publik. Unë kërkoj që ekzekutivi sot të na sjellë emrin e vet dhe ta dimë paraprakisht se a e ka sjellë ekzekutivi emrin e tyre. Le të del dikush në emër të kryetarit dhe të deklarohet që nëse dhe ai dëshiron me sjellë emrin e përfaqësuesit të ti. Ta sjellin emrin dhe për Stacionin e Autobusëve, dhe të ecet përpara me këtë çështje. Faleminderit!

Rrahim Morina: Urdhëro, Alban Mazreku!

Alban Mazreku: Kryesues, na ke sjellë këtë bazën ligjore për themelimin e Komisionit të Aksionarëve, por është mirë që për procesverbal të ceket dhe emertimi i ligjit, në bazë të cilit ligj, sepse ne e kemi vetëm një fletë në kuadër të ati ligji, ndërsa në vendim të jetë dhe emërtimi i ligjit.

Rrahim Morina: Urdhëro, Avdi!

Avdi Morina: Përshëndetje për të gjithë kolegët! Mendoj se qysh në seancën që e kemi pasur javën e kaluar, e kemi vërejtur se ne si kuvend nuk kemi qenë të përgaditur. Kryesues, nuk ka ndonjë ndryshim as në përbërje të materialit, që kjo pikë e rendit të ditës të mbahet si duhet. Është dashur të njoftohet dhe zyra e Kryetarit, që ta sjellë emrin e përfaqësuesit të tyre. Ne ishim atë ditë dhe dhamë propozimin që kjo pikë të shtyhet për një mbledhje të rregullt, dhe të kalon nëpër Komitetin për Politikë dhe Financa, por ju e thatë që ne do të bëhemi gati për seancë të jashtëzakonshme. Po vërehet që përveç kësaj, asgjë tjetër nuk keni sqaruar. Në bazë të cilit ligj është thirrur kjo mbledhje. Kjo është vetëm një nguti sa për ta formuar një komision, sepse këtu po shihet shumë mangësi.

Rrahim Morina: Avdi, ekzekutivi është njoftuar dhe e dinë që duhet ta sjellin emrin e përfaqësuesit të tyre. Mbledhja është thirrur në bazë të ligjit, shkruan dhe neni. Thotë në bazë të nenit 44 paragrafi 6 i ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15,qeshor 2008). Po të tregoj dhe cili ligj është ligji nr.03/L 087 për ndarmarrjet publike.

Avdi Morina: Kryesues, për çdo seancë të jashtëzakonshme është rendi i ditës që vjen, dhe në çoftëse ka një pikë të rendit të ditës caktohet në bazë të cilit ligj, në bazë të cilës rregullore është thirrur kjo seancë. Nuk na ka ardhur asnjë pikë e rendit të ditës në material. Unë mendoj që është pa përgjegjësi e juaja.

Rrahim Morina: Unë kam menduar që sekretaria e kuvendit i kanë shpërndarë ftesat. Avdi ke të drejt, ju kërkoi falje. Tani ju sjellim ftesën. Urdhëro, Alban Mazreku!

Alban Mazreku: Kryesues, a ke marrë masa ndaj sekretaries?

Alban Krasniqi: Ne nuk i dimë motivet pse nuk është shpërndarë materiali, mirëpo e dimë mirë që pikat që janë të nxehta nga pak nga politika, po ndërhyjnë te kryesuesi. Si antarë i Komisionit Komunal të Aksionarëve në tre raste e kam përjetuar që asistententat nuk ma kanë asistuar në mbledhjet të cilat i kemi mbajtur, dhe është detyruar vetë kryesuesi ta mbajë procesverbalin, që për mua ka qenë fyese për këtë, dhe shumë e rëndë që ekzekutivi me ndërhy deri te puntorët. Ka qenë kërkesë e juaja me shty këtë pikë, e kemi shty dhe mendoj që kemi qenë korrekt. Procesi ecë, nëse jemi të interesuar me zgjedhjet. Kjo vonesë dhe ky funksionim i përfaqësuesve të komunës në bordin e Ekoregjionit, me gjithë respektin për përfaqësuesin ka qenë i paligjshëm.

Nëse shkojmë me procese gjyqësore nuk del fitues as përfaqësuesi dhe as kryetari i komunës. Ideja është që një funksionimi të paligjshëm me ju kthij në ligjshmëri dhe këtë fakt na ka fshehur vetë kryetari. Na kanë fshehur deri sa e kemi zbuluar vetë mbi të drejtën që e kemi pasur si antarë të kuvendit. Nuk është e vetmja kjo. Kërkoj që njerëzit e asambles komunale të jenë në krye të detyrës, sidomos shefat e grupeve sepse e kemi njëfarë përgjegjësie, dhe pse i takojmë grupe të ndryshme politike, por kur dakodohemi në parim për disa çështje ecim përpara pa marrë parasysh rezultati përfundimtar si del. Për mua rezultati përfundimtar është valid dhe është i vlefshëm vetëm nëse ne i zgjedhim disa përfaqësues që me punët e tyre i plotësojnë ato dy parakushtet që unë i thash. Nëse ata nuk i plotësojnë ato kritere, kotë nëse unë kam votu për ose kundër.

Rrahim Morina: Urdhëro, Luan!

Luan Kryeziu: Përshëndetje për të gjithë! Dhe unë ju kisha bashkangjitur parafolësve. Kisha dashur disa sqarime të kjo pjesa e anës ligjore. E lexova të neni 5 paragrafi 5.2, ku i referohet çështjes së formimit të komisionit të Aksionarëve, që duhet një antarë nga zyra e kryetarit dhe një antarë nga kuvendi komunal. Por, të çështja e emrave duhet me qenë prezent kur të bëhet votimi si rregull, dhe e vërejta se po kërkohet me shumicë votash, që është mirë me u dhanë një sqarim të kjo pjesa shumica, dhe pse nuk janë të definuara në rregulloren e kuvendit se sa i bë numri shumica thjeshtë dhe shumica absolute. Faleminderit!

Rrahim Morina: Në rregulloren e kuvendit janë të saktësuara të gjitha, dhe janë ligjet për qeverisje lokale. Urdhëro, Valon!

Valon Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë! Dhe ne pajtohemi për themelimin e këti komisioni.

Rrahim Morina: Urdhëro, Avdi!

Avdi Morina: Unë e di që zyra e kryesuesit i ka 1 ose 2 asistent që punojnë të kryesuesi, dhe e kanë për obligim që në seancë të jashtëzakonshme, me na sjellë rendin e ditës. Nuk është në rregull, kur nuk je mirë ka faj ekzekutivi. Këtë rend të ditës është dashur ta shpërndajë zyra e kryesuesit.

Rrahim Morina: Shkojmë në votim. Votohet për formimin e Komisionit të Aksionarëve Ekoregjioni Jugor njësi në Malishevë.

Kush është për?

Për: 21

Kundër: 0

Abstenim: 0

21 antarë të kuvendit janë prezent dhe 21 kanë votuar për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ekoregjionin Jugor njësi në Malishevë.

Shkojmë me propozime të antarëve të kuvendit. Kuvendi i nxjerrë 2 antarë. Urdhëro, Valon!

Valon Krasniqi: Në cilësin e asamblesitit të kuvendit komunal të Malishevës, propozoj Arlind Morina që të jetë antarë i këtij komisioni.

Rrahim Morina: Faleminderit! Urdhëro, Sylë!

Sylë Dukolli: Në cilësin e asambleistit të Nismes Socialdemokrate propozojm Halil Morina.

Rrahim Morina: Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj: Ne si grup parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës propozojm Alban Mazrekun si antarë të Komisionit Komunal të Ekoregjionit.

Rrahim Morina: Muharrem a ke ndonjë propozim nga zyra e Kryetarit.

Muharrem Morina: Unë, autorizim nuk kam për me u marrë me këtë çështje.

Valon Mazreku: Zyra e Kryetarit e zgjedh emrin në mbledhjen tjetër.

Rrahim Morina: Kryetari e ka një përfaqësues nga zyra e t'i, dhe nëse nuk është i gatshëm për këtë mbledhje e sjellë në mbledhjen tjetër dhe e votojm në mbledhjen tjetër. Unë dhe një herë i drejtohem me shkrim kryetarit. Sot i zgjedhim dy antarë të kuvendit. I kemi tre propozime Arlind Morina, Halil Morina dhe Alban Mazreku. Urdhëro, Valon!

Valon Krasniqi: Kryesues, a është më mirë që secili prej antarëve me hy në votim, sepse nuk mundet me ju ba e padrejtë antarit të tretë.

Sylë Dukolli: Një sqarim po kërkoj. Antarin që e propozon zyra e kryetarit a duhet të marrë dhe ai votën e asambles apo vetëm do t'i bashkangjitet grupit që votohet këtu.

Rrahim Morina: Po, dhe ai do t'i merr votat e kuvendit .3 antarët i hedhim në votim dhe dy antarët që marrin vota më shumë i bashkohen komisionit komunal të Aksionarëve Ekoregjioni jugor njësisia në Malishevë. Prezent në sallë janë 22 antarë. Shkojmë sipas propozimeve. Kush është që Arlind Morina të jetë antarë i komisionit komunal të Aksionarëve Ekoregjioni Jugor njësisia në Malishevë.

Kush është për?

Për: 12

Kundër: 10

Abstenim: 0

Shkojmë te propozimi tjetër për antarin Halil Morina.

Kush është për?

Për: 11

Kundër: 11

Abstenim: 0

Shkojmë te propozimi tjetër për Alban Mazrekun.

Kush është për?

Për: 14

Kundër: 6

Abstenim: 2

Antarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve janë Alban Mazreku me 14 vota për, 6 kundër dhe 2 abstenime dhe Arlind Morina me 12 vota për dhe 10 kundër. Pra, këta dy bëhën antarë të komisionit komunal të Aksionarëve, Ekoregjioni Jugor njësia në Malishevë. Atëherë, kërkojm nga kryetari që ta sjellë emrin e përfaqësuesit të vetë për mbledhjen tjetër, dhe ta votojm.

Avdi Morina: Kryesues, është mirë çështjen e votimin me sqaru. Unë mendoj që është shkelje, sepse kur janë votuar dy të parët, unë mendoj që janë shkuar dy të parët. mendim i imi është. Por, në qoftëse ka diqka tjetër është më mirë që të na sqaron Muharremi.


Alban Krasniqi: Secili kandidim dhe secili përfaqësim këtu duhet t'i nënshtrohet votimit. Çka nëse Halili të kishte qenë i treti, kjo po i bie që kush propozon i pari, ai propozim votohet. Nuk ka lidhje kjo nuk është në parim. Secili që propozohet votohet.

Rrahim Morina: Nëse dikush mendon që është bërë shkelje e procedures, mund t'i drejtohet MAPL-së. Ju u pajtuat që të hynë të gjithë në votim, dhe ne i futum të tre propozimet në votim. Komisioni Komunal i Aksionarëve ka mandat sa është mandati i antarëve të kuvendit komunal. Me ditën që përfundon mandati i antarëve të kuvendit, përfundon dhe mandati i antarëve në Komisionin Komunal të Aksionarëve. Këtë mbledhje e shpalli të përfunduar.

Mbledhja përfundoi në ora: 11:30.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



Kryesuesi i Kuvendit

